



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 27 qershor 2016

Numri i lëndës: 2015-01

Milos Jokic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 qershor 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Elka FILCHEVA – ERMENKOVA, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar me 11 shkurt 2015. Për shkak të dorëheqjes së znj. Katja Dominik si anëtare e Panelit, pas shqyrtimit ajo u zëvendësua nga znj. Elka Filcheva-Ermenkova, anëtare

zëvendësuese e Panelit, në përputhje me rregullin 14 par. 2 të rregullores së punës.

II. FAKTET

2. Faktet e parashtruara nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë.
3. Ankuesi ishte arrestuar me 26 gusht 1999 me dyshimin e kryerjes së veprave të gjenocidit. Ai ishte dënuar për krime të luftës dhe ishte dënuar me njëzet vjet burgim me 20 qershor 2000. Si rezultat i një rigjykimi me 3 maj 2002, ai ishte liruar nga të gjitha akuzat dhe ishte liruar nga paraburgimi.
4. Në prill 2009, ankuesi ka paraqitur një kërkesë për kompensim ndaj Qeverisë së Kosovës për paraburgimin e paarsyeshëm në Gjykatën Themelore të Prishtinës, zyra e degës në Graçanicë. Nga të dhënat në dispozicion të Panelit, duket që gjykatësi që fillimisht ishte caktuar në lëndën e tij ishte promovuar në një gjykatë më të lartë në një datë të pasaktësuar në vitin 2012 dhe se asnjë zëvendësim nuk ishte caktuar lidhur me lëndën. Gjithashtu duket se seanca në këtë rast ende nuk është caktuar.
5. Në një datë të pasaktësuar në vitin 2009, ankuesi ka kërkuar nga EULEX-i të marrë përsipër lëndën e tij. Me 18 tetor 2009, gjykatësi i EULEX-it është përgjigjur se lënda nuk ka hyrë në kuadër të mandatit të Misionit dhe e ka këshilluar ankuesin që të ndjek procedurën e rregullt civile.
6. Ankuesi ka përsëritur kërkesën e tij me 26 mars 2010, 8 shkurt 2011, 15 tetor 2012 dhe 3 mars 2014. Secilën herë (letrat e datës 9 dhjetor 2011, 5 korrik 2011, 16 tetor 2012 dhe përkatësisht 22 tetor 2014) ai ishte informuar nga gjykatësit e EULEX-it apo zyrtarët ligjorë se në përputhje me nenin 5 të ligjit nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it, lënda nuk ka hyrë në kuadër juridiksionit të gjykatësve të EULEX-it. Kërkesa e tij sa i përket kompensimit për heqjen e lirisë nuk mund të konsiderohet kërkesë “që ka të bëjë me pronën” brenda kuptimit të këtij neni.

III. ANKESAT

7. Ankuesi pohon se e drejta e tij për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme, e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe me nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (Deklarata) është shkelur. Ai gjithashtu pohon se nuk kishte mjete

efektive juridike për të parandaluar shkeljet e mëtejshme të të drejtave të tij, duke shkelur nenin 13 të Konventës dhe nenin 8 të Deklaratës. Ai më tej pohon se ka pasur një shkelje të nenit 5(5) të Konventës (e drejta për kompensim për burgim të paligjshëm).

IV. LIGJI

8. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
9. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
10. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
11. Paneli rithekson se ashtu siç ka konstatuar në shumë raste, sipas rregullës 25, paragrafi 1, i bazuar në konceptin e llogaridhënies të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë, në parim nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Këto hyjnë brenda kompetencave ekskluzive të gjykatave të Kosovës (shih në mesin e shumë të tjerëve *Shajp Selmani kundër EULEX-it*, 2014-23, 10 nëntor 2014, §12, *Gani Gashi kundër EULEX-it*, 2013-22, 7 prill 2014 § 11).
12. Thelbi i ankesës duket se ka të bëjë ekskluzivisht me veprimet apo dështimet e pretenduara të gjyqësorit të Kosovës. Prandaj rezulton se kjo ankesë nuk bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Kështu lënda bie jashtë fushëveprimit të kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it.
13. Së fundi Paneli konstaton se nuk ishte se pozicioni i marrë nga EULEX-i në lidhje me autorizimin e Misionit për ta marrë përsipër lëndën ishte i paarsyeshme apo se kishte dalë përtej kompetencave të tyre.

14. Siç u përmend më lartë, Paneli nuk ka juridiksion mbi ankesën pa ndonjë përfshirjeje nga EULEX-i në procedurën pranë gjykatës së Graçanicës dhe pa ndonjë tregues të ndonjë shkeljeje të shkaktuar nga refuzimi i Misionit për të marrë përsipër lëndën. Megjithatë Paneli nuk mund të mos konstatoj me shqetësim kohëzgjatjen e përgjithshme të këtyre procedurave dhe arsyeve të dukshme për të. Procedurat janë zhvilluar për më shumë se gjashtë vite. Seanca lidhur me lëndën ende nuk është mbajtur, ndërsa asnjë gjykatës nuk është caktuar në këtë lëndë për këtë qëllim që prej promovimit të gjykatësit kompetent në një gjykatë më të lartë në vitin 2012. Në mungesë të kompetencave të Panelit mbi këtë çështje, i bie ankuesit të ngritë çështjen e përputhshmërisë së saj me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese